



PROCEDURA DISIPLINORE NDAJ NDËRMJETËSUESVE

Hapat që duhet të ndërmerren në rast të shkeljeve disiplinore nga ana e ndërmjetësuesit:

Çka konsiderohet shkelje disiplinore e ndërmjetësuesit?

Shkelje disiplinore të kryera nga ndërmjetësuesi konsiderohen:

- kryerja e veprës penale ose kundërvajtjes që është në kundërshtim me etiken, detyrat dhe obligimet e ndërmjetësuesit
- kryerja e kundërligjshme apo e pandërgjegjshme e detyrës zyrtare si ndërmjetësues, në kundërshtim me ligjin për ndërmjetësim, kodin e mirësjelljes të ndërmjetësuesve, dhe legjislacionin përkatës
- mos ndjekja në mënyrë të vazhdueshme e trajnimeve
- sjellja jo profesionale dhe mosrespektimi i parimeve dhe procedurës së ndërmjetësimit
- mosrespektimi i tarifave të përcaktuara me aktin përkatës për tarifat e ndërmjetësuesve
- shkelja e obligimit për ruajtjen e fshehtësisë së deklaratave dhe dokumenteve të palëve në procedurë gjatë apo edhe pas përfundimit të procedurës së ndërmjetësimit, përveç rasteve të përcaktuara me legjislacion përkatës
- shkelja e dispozitave të kodit të mirësjelljes së ndërmjetësuesve
- konkurrenca jo-lojale



Çfarë masash disiplinore mund të shqiptohen ndaj ndërmjetësuesve për shkeljet e kryera disiplinore?

Ndaj ndërmjetësuesit që ka kryer shkelje disiplinore, mund të shqiptohen këto masa:

- vërejtje me shkrim;
- gjobë nga njëqind (100) deri në pesëqind (500) Euro;
- propozim për pezullim apo revokimin e licencës nga Ministri i Drejtësisë.

Si mund të fillohet procedura disiplinore ndaj ndërmjetësuesve ?

Duhet të ketë ndodhur shkelja disiplinore nga ndërmjetësuesi

Të paraqitet fletëparaqitje ndaj ndërmjetësuesit

Kush mund të paraqes fletëparaqitje ndaj ndërmjetësuesit?

Çfarë duhet të përmbaj fletëparaqitja ndaj ndërmjetësuesit?

Fletëparaqitje kanë të drejtë të paraqesin këta persona:

- *palët në procedurën e ndërmjetësimit
- * ndërmjetësuesit
- *referentët për ndërmjetësim në kuadër të gjykatave apo prokurorive themelore
- * Oda e ndërmjetësuesve, dhe
- *Divizioni për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së profesioneve të lira në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë

Fletëparaqitja duhet të përmbajë:

- *emrin, mbiemrin dhe adresën e ndërmjetësuesit
- *përshkrimin e shkeljes së pretenduar dhe provat
- *propozimin për masën disiplinore, dhe
- *të dhënat e iniciuesit të procedurës disiplinore

Fillimi i Procedurës Disiplinore ndaj ndërmjetësuesit

Procedura disiplinore ndaj ndërmjetësuesit fillon nga data e dorëzimit të fletëparaqitjes në Departamentin për Profesionet e Lira në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë

Nëse fletëparaqitja nuk i përmbanë elementet që duhet t'i ketë, zyrtari përgjegjës në Departamentin për Profesionet e Lira do ta kontaktojë fletë paraqitësin që brenda tetë (8) ditëve ta plotësojë fletëparaqitjen.

Komisioni Disiplinor pas pranimit të fletëparaqitjes disiplinore në afat prej pesë (5) ditëve, me konkluzion e hedhë poshtë fletëparaqitjen si:

1. jo të plotë, nëse nuk i përmban të dhënat që kërkohen; dhe
2. jo të lejuar, nëse nuk është paraqitur nga personat e autorizuar

Nëse Komisioni brenda afatit prej pesë (5) ditëve nuk e hedhë poshtë fletëparaqitjen, një kopje të saj bashkë me shtojcat e bashkangjitura ia dërgon ndërmjetësuesit, i cili brenda dhjetë (10) ditëve, ka të drejtë të deklarohet me shkrim tek Komisioni lidhur me përgjegjësinë e tij, dhe mund të paraqet fakte apo argumente që e mbështet pozitën e tij ligjore.

Komisioni disiplinor është i pavarur dhe merr vendim në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim, Kodin e Mirësjelljes së Ndërmjetësuesve dhe legjislacionin relevant.
Procedura disiplinore për ndërmjetësuesit në *shkallë të parë* zhvillohet para Komisionit Disiplinor. Komisioni disiplinor themelohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë me mandat tre (3) vjeçar i cili përbëhet nga tre (3) anëtar, dy (2) prej të cilëve janë me mandat të plotë, një (1) anëtar që zgjidhet sipas rasteve i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës ndërsa një anëtar i propozuar nga Oda e Ndërmjetësuesve.
Komisioni ka këtë përbërje:
1. një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, kryesues;
2. një gjyqtar i propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtarë;
3. një ndërmjetësues i licencuar, të cilin e propozon Oda e ndërmjetësuesve, sipas rasteve.

Komisioni Disiplinor mban seancë disiplinore ndaj ndërmjetësuesit
Për rrjedhën e seancës mbahet procesverbal
Ndërsa lidhur me vendimin e Komisionit, përpilohet procesverbal i veçantë

Vendimi i Komisionit Disiplinor
Pas mbajtjes se seancës disiplinore, Komisioni me shumicë votash merr vendim me të cilin ndërmjetësuesit i shqiptohet masa disiplinore ose lirohet nga përgjegjësia.

Ankesa
Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita pranimit të vendimit. Ankesa i drejtohet Ministrit të Drejtësisë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita pranimit të vendimit.
Ministri i Drejtësisë vendosë lidhur me ankesën në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të ankesës.
Vendimi i Ministrit të Drejtësisë është përfundimtar, ndërsa pala e pakënaqur, kundër këtij vendimi mund të fillojë Konflikt Administrativ në gjykatën kompetente.

Përfundimi i procedurës disiplinore ndaj ndërmjetësuesit

Procedura disiplinore duhet të përfundojë brenda periudhës tre (3) mujore nga data e fillimit të procedurës.